



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 28
Prishtinë, më 25.07.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Evgjeni Thaçi-Dragusha dhe Zafir Berisha.

Munguan: Danush Ademi, Glauk Konjufca, Fitore Pacolli, Doruntinë Maloku-Kastrati dhe Sërgjan Mitroviq.

Pjesëmarrës nga MeDIS: Dardan Gashi, zëvendëskryeministër dhe ministër i Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike me bashkëpunëtorët: Lorik Pustina, Shyhrete Gosalci, Burim Krasniqi dhe Avdyl Lipoveci.

Pjesëmarrësit e tjerë: Gresa Maxhuni, KDI; Fjolla Vukshinaj, Liza Gashi, Germin; praktikantë dhe media.

Nga zyra e komisionit: Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 12 dhe 20 qershor 2018;**
- 3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, z. Dardan Gashi;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratim i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 12 dhe 20 qershor 2018

Kryetarja konstatoi se komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 12 dhe 20 qershor 2018.

3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, z. Dardan Gashi

Vjosa Osmani-Sadriu, lidhur me raportimin e Ministrit Gashi, theksoi se Komisioni është i interesuar që të njoftohet lidhur me funksionimin e qendrave kulturore, implementimin e marrëveshjes në mes të Kosovës e Shqipërisë lidhur me diasporën, sfidat në zbatimin e ligjit aktual për diasporën aktivitetet që organizohen këtë vit për diasporën, kërkesat të cilat kanë dalë nga organizata Germin lidhur me të drejtën e votës dhe përfaqësimin e saj në Kuvend, kartonin e gjelbër, si dhe lidhur me kërkesën për kanal të veçantë televiziv për diasporën.

Dardan Gashi bëri të ditur se kanë pasur një takim të përbashkët me diasporën dhe se janë duke punuar së bashku me Shqipërinë, për hapjen e një kanali televiziv të përbashkët për diasporën. Sa i përket kartonit të gjelbër tha se kjo çështje ndërlidhet me çështjen e mosnjohjes së Kosovës nga shumë shtete që janë anëtare të asociacionit të Kartonit të Gjelbër dhe se janë duke diskutuar më se tre muaj këtë çështje në nivel politik dhe të byrove të sigurimit të Austrisë dhe Kosovës për të gjetur një zgjidhje. Deri tani tha se kemi arritur ta ulim tarifën e policës kufitare nga 50 në 15 euro dhe se pagesa mund të bëhet online. Lidhur me përfaqësimin e diasporës në Kuvend tha se ka shumë ide, por më e theksuara është që të kenë për 5-7 vende të rezervuara. Lidhur me funksionimin e qendrave kulturore njoftoi se nuk kanë bazë ligjore në vendet ku ato operojnë dhe si të tilla duhet të mbyllen. Punonjësit të cilët punojnë në ato qendra duhet të emërohen atashë për diasporë, në ambasadat tona në vendet kyçe ku ka më shumë diasporë, tha ai. Bëri të ditur se në kuadër të përmbylljes së marrëveshjes me Shqipërinë, në vitin e ardhshëm do të fillojë hapja e qendrave të përbashkëta kulturore duke u kujdesur që të kenë bazë ligjore.

Vjosa Osmani-Sadriu theksoi se çështja e kartonit të gjelbër dhe e drejtës së votës së diasporës nuk janë çështje që varen nga ministria përkatëse megjithatë, ministria duhet të insistojë brenda koalicionit qeverisës dhe të dalë me propozime konkrete dhe të mos pres nga KQZ t'i rregullojë këto çështje, për t'i shmangur problemet administrative dhe të mos dekurajoj diasporën për procese të rëndësishme në Kosovë. Më tej cekur se një numri të madh të diasporës përkundër aplikimit i është refuzuar e drejta e votës me postë. Duke cekur se Austria për pesë vite ka gatishmërinë që të na ndihmojë për kartonin e gjelbër dhe ende nuk ka rezultate, pyeti se a është kjo mungesë e vullnetit politik që ajo të aplikojë në emër të Kosovës, apo është interes biznesor i 2-3 njerëzve.

Dardan Gashi, sa i përket policës kufitare, tha se kompanitë e sigurimeve të Kosovës dhe të Austrisë janë kompani private dhe shteti nuk mund të ndikojë në ato që të marrin obligime për Kosovën. Njoftoi për takimet e përbashkëta me Bankën Qendrore, Byronë e sigurimeve, Byronë e sigurimeve të Austrisë dhe ambasadorin e Austrisë, për të cilat tha se ka pasur vullnet të mirë, por nga aspekti financiar ekziston pasiguria e kompanive financiare me marrë përsipër riskun. Tentimi i fundit që të binden këto kompani tha se është që të marrim përsipër me Bankën Qendrore garancinë financiare. Bëri të ditur se nuk ka pasur pengesa që të merret me këtë çështje, por se problemi qëndron në Bruksel dhe është kryekëput i natyrës politike sikurse anëtarësimi edhe në organizata të tjera ndërkombëtare. KQZ tha se ka dështuar sa i përket pjesëmarrjes në zgjedhje të diasporës dhe nuk ka reaguuar në shkresat dhe konceptet të cilat i janë përcjellë për përmirësim të gjendjes. Sa i përket pjesëmarrjes në votim të diasporës tha se ka mundësi që edhe pa ndryshime kushtetuese të përmirësohet situata, por është e nevojshme ndihma e subjekteve politike.

Vjosa Osmani-Sadriu kërkoi nga ministri që shkresat të cilat i kanë drejtuar në KQZ, lidhur me zgjedhjet e diasporës, t'i përcillen një kopje edhe komisionit, në mënyrë që edhe komisioni të ju drejtohet për ndërmarrjen e masave të duhura.

Evgjeni Thaçi-Dragusha, mes tjerash, falënderoi ministrin për bashkëpunimin dhe qasjen konstruktive të ministrisë gjatë punës së grupit punues për mbikëqyrjen e Ligjit për diasporën dhe

mërgatën. Njoftoi se nga ministria kanë marrë përgjigjet me shkrim në pyetjet e grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në fjalë. Sa i përket kartonit të gjelbër theksoi se në Kuvend është zhvilluar një debat i gjerë dhe është votuar një rezolutë përmes së cilës është mbështetur Komisioni për Buxhet që të bëjë koordinimin e punës lidhur me anëtarësimin e Kosovës në kartonin e gjelbër. Ajo theksoi se shpreson që me ligjin e ri për diasporën të zgjidhet problemi ekzistues lidhur me qendrat kulturore dhe ligjin për prokurimin. Sipas nenit 10 të ligjit në fuqi, theksoi se në kuadër të Muzeut të Kosovës nuk është themeluar seksioni për diasporën dhe mërgatën, e që do të ishte e nevojshme.

Vjosa Osmani-Sadriu theksoi se MDIS në bashkëpunim me MPJ e cila po ashtu është fazën e hartimit të ligjit për MPJ dhe Shërbimin e jashtëm, do të mund të parashihnin një nen i cili i mbulon qendrat kulturore.

Shyhrete Gosalci, sa i përket implementimit të nenit 10 të ligjit, njoftoi se në mandatin e parë është diskutuar që të lidhet një marrëveshje me Ministrinë e Kulturës ku përfshihet seksioni i eksponentëve e materialeve arkivore jashtë dhe se kanë hartuar një rregullore, e cila për shkak të mungesës së vullneti politik nuk është miratuar. Ajo njoftoi se ministria e ka pasur edhe personin përgjegjës i cili ka mbledhur shumë materiale të cilat i ka sjellë në muze, por kjo nuk ka vazhduar në mungesë të vullnetit politik.

Time Kadrijaj falënderoi ministrin për raportin e dërguar me shkrim duke shtuar se bazuar në këtë raport ministria i ka identifikuar problemet e saja dhe pyeti se kur do të fillohet që të gjitha këto probleme që janë parashtruar në raport të zgjidhen. Sa i përket çështjes së votimeve, tha se kjo është mjaft shqetësuese pasi që prej 700 000 përfaqësuesve të diasporës maksimumi i votave i cili ka arritur në Kosovë është 10 000. Znj. Kadrijaj tha se komisioni së bashku me ministrinë mund ta ftojë KQZ-në në një takim dhe të diskutohen mundësitë administrative që të lehtësohet votimi në diasporë. Pozitive, znj. Kadrijaj e vlerësoi organizimin e aktivitetit “Ditët e Diasporës” meqë diaspora po ndihet mirë në cilindo qytet që është organizuar ky aktivitet tha ajo. Pyeti se pse anëtarët e komisionit nuk janë ftuar në një tryezë të organizuar nga ministria me temën “Roli i gruas në diasporë”.

Dardan Gashi, njoftoi se i kanë identifikuar problemet dhe se kanë filluar t’i mënjanojnë disa, siç është mbyllja e qendrave kulturore. Disa aspekte të kartonit të gjelbër tha se kanë përfunduar dhe se pjesa tjetër do të përfundojë shpejt. Sa i përket aktiviteteve të diasporës, ministri njoftoi se me 15 komuna kanë marrëveshje për bashkëpunim, se kanë filluar në Gjilan, kanë pas aktivitet në Prishtinë me gratë të artizanateve e prodhimeve vendore dhe do të përfundojë më 1 gusht në Prekaz dhe më 2 gusht në Prishtinë. Ai njoftoi se më 2 gusht do të bëhet ndarja e çmimeve për aktivistë që ndërlidhen me diasporën dhe kjo do të mbahet në rezidencën e Presidentit Rugova për herë të parë. Sa i përket web-faqes së ministrisë, tha se është identifikuar edhe ky problem, është mbyllur një web-faqe dhe është dizajnuar një web-faqe e re, e cila do të lansohet së shpejti dhe se është bërë me forca të brendshme pa tender. Platforma për regjistrimin e diasporës është riaktualizuar dhe riformatuar me buxhet të brendshëm, njoftoi ministri. Buxheti i Ministrisë së Diasporës tha se është më i varfëri, dhe se kërkesat janë të mëdha për aktivitete si në Kosovë ashtu edhe në diasporë, kurse në vit maksimum 100 000 euro janë të ndara për aktivitete të tilla. Ministri po ashtu njoftoi se Banka Qendrore ka lajmëruar rreth 740 milionë euro remitencë nga diaspora për vitin 2017, kurse ministria i ka vetën 100 000 euro për t’ia kthyer këtë nderë diasporës, ky relacion nuk përputhet dhe duhet të përmirësohet, shtoi ai.

Vjosa Osmani -Sadriu tha se në raportimin e fundit para se të miratohej buxheti, komisioni ka kërkuar nga ministri që të njoftoi lidhur me kërkesat buxhetore të ministrisë, meqë komisioni mund të propozojë amendamente dhe se ministria nuk ka bërë asnjë kërkesë për buxhet shtesë. Osmani Sadriu kërkoi nga ministri që t’i identifikojë kërkesat buxhetore dhe nëse nuk kalojnë në Qeveri atëherë t’i drejtohen komisionit, i cili përmes amendamenteve mund të kërkojë shtimin e

buxhetit për të mbuluar aktivitetet e ministrisë. Ajo pyeti ministrin se sa kanë qenë efektive vizitat e tij jashtë vendit për të promovuar dhe afruar raportet ndërmjet Kosovës dhe diasporës.

Zafir Berisha, sa i përket shifrës prej 700 000 pjesëtarëve të mërgatës, theksoi se numri i mërgatës tonë është shumë më i madh dhe pyeti se a ka përfunduar procesi i regjistrimit të diasporës. Sa i përket mbylljes së qendrave kulturore shprehu mendimin se ky veprim është vulgar, dhe se ky problem duhet të adresohet më ndryshe, duke shtuar se mërgata jonë në shumë vende është e organizuar, por mungon një person i autorizuar nga stafi diplomatik i cili merr pjesë në këto organizime për t'i stimuluar. Ideja e fundit që të takohen mërgimtarët në këtë formë në Kosovë tha se nuk është e keqe, ne mund t'iu mbështesim në shtimin e buxhetit nëse keni ide dhe projekte për të cilat kërkohet mbështetje. Sa i përket votimit të diasporës pyeti se a ka sjellë rezultat regjistrimi i votuesve dhe se a ka mbetur punë tjetër për t'u bërë. Pyeti ministrin se cili ka qenë obligimi i tij dhe se çfarë është bërë gjatë vizitës së një delegacioni të Qeverisë në Bruksel.

Dardan Gashi, sa i përket regjistrimit të diasporës, njoftoi se ky proces si proces fizik ka përfunduar me rreth 300 000 persona të regjistruar dhe se është duke vazhduar në mënyrë digjitale. Ai njoftoi se te pjesa ku blihet policia kufitare do të afrohet edhe regjistrimi i diasporës dhe se janë duke tentuar që përmes web-faqeve dhe ambasadave të vazhdojë ky proces jo vetëm për individët, por edhe për organizata jo qeveritare, shoqata dhe biznese. Lidhur me vizitën e tij në Bruksel, njoftoi se ka qenë pjesë e delegacionit të Qeverisë, se janë takuar me përfaqësues të Departamentit të Shtetit Amerikan, me znj. Mogherini dhe me komisionarin Avramopoulos në ndërlidhje me liberalizimin e vizave dhe me hapat e mëtutjeshëm. Qeveria tha se nuk ka marrë pjesë në asnjë takim që mund të quhet negociatë. Me zonjën Mogherini tha se është diskutuar nevoja e përfshirjes së opozitës në proces, po ashtu edhe me përfaqësuesit e departamentit të shtetit.

Elmi Reçica tha se është për t'u parapëlqyer përgjigjja e Ministrit Gashi në ftesën e komisionit dhe se kjo është një nga format e mira për të komunikuar dhe bashkëbiseduar. Kur bëhet fjalë për diasporën Reçica tha se nuk flitet vetëm për numra, por për një kualitet që e posedon diaspora dhe se nuk është diaspora e viteve të hershme, por është një diasporë që është zhvilluar dhe që ka depërtuar fuqishëm në institucionet e vendeve ku jetojnë. Pyeti se sa janë gjasat që të organizohet diaspora përmes bashkësive shqiptare të Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi, dhe të shfrytëzohen mundësitë që i jep shteti. Sa i përket investimeve strategjike, tha se ne, si shqiptarë jemi si individë të fuqishëm, por problem e kemi punën ekipore, të njëjtin problem e ka edhe diaspora jonë që të bashkohet. Lidhur me këtë pyeti se sa mund të ndikoni ju dhe ne së bashku që tek investimet strategjike si Brezovica, diaspora të bashkohet dhe të investojë në Kosovë. Ai tha se ne jemi duke biseduar për rritjen e buxhetit, por buxhetin e kemi aq sa e kemi dhe nëse nuk kemi zhvillim ekonomik dhe rritje ekonomike dhe nëse nuk kemi investime ne do ta kemi problem rritjen e buxhetit për t'i mbuluar nevojat dhe kërkesat që janë të domosdoshme.

Dardan Gashi, sa i përket bashkësisë shqiptare, tha se ideja e marrëveshjeve që i kemi me Shqipërinë dhe pjesërisht me Maqedoninë është pikërisht kjo që të mos jetë e ndarë diaspora e Kosovës, e Shqipërisë, e Maqedonisë dhe e Malit të Zi, por të jetë një diasporë sa i përket aspektit etnik shqiptar. Vizitat jashtë vendit tha se janë duke i zhvilluar kryesisht me z. Majko dhe nganjëherë me ministrin e Maqedonisë. Ai njoftoi për vizitën e tij në Itali, për takimet me arbëreshët dhe për gjuhën arbëreshe, e cila nuk ishte e pranishme në shkolla. Lidhur me këtë tha se në bashkëpunim me ministrin Majko dhe kryetarët e disa komunave arbëreshe kanë takuar zyrtarë italianë të cilët e kanë mirëpritur dhe pranuar kërkesën që të mësohet gjuha arbëreshe në shkolla. Sa i përket investimeve strategjike tha se janë së paku 4 investitorë potencialë me dy prej të cilëve së bashku kanë negociuar me Bankën Botërore dhe IFC-në për t'i mbështetur dy projekte të energjisë në Kosovë dhe pritet që brenda këtij viti të fillojnë të investojnë. Ministri njoftoi për nënshkrimin e një memorandumi bashkëpunimi me Agjencinë Kosovare të Privatizimit përmes së cilës, ministrisë i janë dorëzuar një mori asete për shkak të mundësisë më të madhe që i jep Ligji

për Investime Strategjike për një proces të tillë se sa procesi i privatizimit. Ai po ashtu tha se në shtator Ministria, AKP-ja dhe KIESA do të prezantojnë në Amerikë dhe Evropë asetet të cilat i afron Kosova ku janë të përfshira hoteli Grand, Brezovica, disa miniera dhe asete të tjera që janë interesante për investitorë të huaj.

Elmi Reçica, lidhur me organizimin e qendrave kulturore si Gjenevë e Berlin ku jetojnë shumë shqiptarë, tha se nëse bëhen bashkë të zgjedhin vetë përfaqësuesit e vet do të kenë mbështetje të përfaqësojnë në të gjitha segmentet. Një organizim i përbashkët i bashkësisë shqiptare nëpër botë, është një hap më tutje se sa qendrat kulturore, por se për këtë nevojitet një studim i mirëfilltë dhe një koordinim, për të mos prodhuar një efekt ndryshe.

Dukagjin Gorani, në diskutimin e tij mes tjerash pyeti ministrin për televizionin e përbashkët për diasporën, se a ekziston ndonjë grup apo ekip i autorizuar i cili merret me këtë çështje dhe cili është afati kohor për realizimin e këtij projekti të përbashkët. Ai njëkohësisht pyeti edhe për qendrat kulturore se si është e mundur që ato të mos jenë funksionale, të konsiderohen ilegale, gjë e cila tha se paraqet shkelje.

Dardan Gashi tha se qendrat kulturore nuk janë ilegale, por se për hapjen e tyre është dashur të sqarohet statusi i tyre. Qendrat kulturore si të tilla nuk kanë ndonjë rol dhe kanë aktivitete shumë të rralla, prandaj qeveria do të riparoj këtë gabim që i ka hapur.

Lorik Pustina njoftoi se me kërkesë të diasporës ministri i ynë dhe ai i Shqipërisë u akorduan që TV i Shqipërisë të hapë një kanal të veçantë në frekuencat ekzistuese satelitore për diasporën. Ai njoftoi se pas pushimeve verore do të bëhet takimi i parë i përbashkët, përderisa deri më tani ka pasur vetëm këmbime telefonatash dhe kryesisht letra joformale. Sipas dinamikës që po zhvillohet tha se inaugurimi i këtij kanali të veçantë pritet të bëhet deri në fund të vitit. Për këtë program njoftoi se do të prodhohen programe nga dy televizionet, por edhe program i prodhuar nga diaspora. Hapja e këtij programi nuk është paraparë të ketë implikime buxhetore sepse është e paraparë të shfrytëzohen asetet ekzistuese, njoftoi z. Pustina.

Mbledhja përfundoi në orën 15:10.

Kryetarja e komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.